

# community

The New Apostolic Church around the world

03/2019/AI

## Të kuptuarit e postit

Editoriali: Bashkësia jeton  
dhe formohet

Shërbesë fetare:  
Kurora e jetës

Mësimi kishtar:  
Të kuptuarit e postit

New Apostolic Church  
International



# Bashkësia jeton dhe formohet



Foto: NAC International

Të dashur motra e vëllezër të besimit,

pas nesh shtrihen ngjarje madhështore: për disa ditë ne festuam Ditën ndërkombëtare të Rinisë me motra e vëllezër të rinj të besimit nga e gjithë bota. Në këtë rreth të madh shijuar bashkësinë, muzikën dhe bisedat. Për këtë arsye unë jam i bindur, se ju keni dëgjuar tashmë shumë për entuziazmin; edhe pse ju nuk mundët të ishit të gjithë atje.

Një javë më pas ne festuam festën e Pentakostit. Ne e përjetuam shërbesën fetare si një bashkësi e madhe, falenderuam dhe i sollëm lavdërime Trinisë së Perëndisë. Të qënurit së bashku në Grosllar/Gjermani ne e përdorëm edhe për Mbledhjen e parë ndërkombëtare të apostujve të distrikteve dhe ndihmësive të tyre në këtë vit. Që nga shërbesa e Pentakostit hyn në fuqi Të kuptuarit e postit, të cilën e prezantuam në prill. Ne në të ardhmen do të bëjmë dallim midis pushtetit të postit dhe funksionit drejtues. Në tre shkallët e postit bëjnë pjesë posti i diakonit, i priftit dhe i apostulit. Në pesë funksionet drejtuese bëjnë pjesë drejtuesit e bashkësive, të distrikteve, të apostujve dhe apostujve të distriktit si dhe apostulit kryesor.

Nëpër poste do të emërohen vëllezërit. Në funksione drejtuese do të ngarkohen vëllezërit në detyrë nëpërmjet lutjes dhe vendosjes së dorës mbi kokë. Nëpërmjet kësaj mënyre, ne theksojmë rëndësinë e funksioneve drejtuese. Në të ardhmen do të caktohen ndihmësat, për shembull ndihmës apostuli kryesor, ndihmës apostuli i distriktit, bishopët dhe përfaqësuesit e drejtimit të distrikteve dhe bashkësive. Evangjelistët, barinjët, evangjelistët e distriktit dhe kryepleqtë e distriktit nuk do të emërohen

në të ardhmen. Ne e pranojmë të shkuarën dhe vëllezërit do ta kryejnë detyrën e tyre si më parë, pasi kanë marrë emërimin.

Shërbimi i posteve, edhe pse është shumë i rëndësishëm, është megjithatë vetëm një pjesë e shumë shërbimeve, të cilat kryhen në bashkësi. Në emër të gjithë apostujve dëshiroj të falenderoj të gjithë motrat e vëllezërit, të cilët angazhohen në bashkësi dhe që mbështesin punën tonë nëpërmjet sakrificës së tyre. Ju falenderoj me gjithë zemër! Zoti ju bekoftë pa masë.

Të fala të përzemërta

I juaji Jean-Luc Schneider

Apostuli kryesor u takua me 500 besimtarë më 18 nëntor 2018 në Palacio de Maynila, Manila, Filipine. Shërbesa fetare u transmetua në shumë bashkësi nëpërmjet internetit



Foto: NAC Azia Juglindore



Jakobi 1,12

*Secili të gëzohet kur të vihet në provë dhe t'i qëndrojë asaj, sepse Perëndia do t'i japë kurorën e fitimtarit, jetën e përjetshme që u premtoi të gjithë atyre që e duan atë.*

## Kurora e jetës

Të dashur motra e vëllezër, sot është një shërbesë e veçantë fetare. Nuk para ndodh shpesh që në Manila të jetë mbledhur një bashkësi kaq e madhe dhe njëkohësisht, të jenë kaq shumë apostuj të pranishëm. Siç e dini, është gjithashtu një ditë e veçantë, pasi apostuli juaj i distriktit del në pension dhe një apostul i ri distrikti do të ngarkohet me këtë detyrë. Kjo sigurisht e bën këtë ditë paksa më speciale. Ne e përdorim këtë rast për ta falenderuar Atin tonë Qiellor për gjithë bekimin që kemi marrë prej apostulit tuaj të distriktit. Ne e falenderojmë Perëndinë që e ka bekuar punën e tij. Por ju mos u merakosni; edhe nëse ka një ndryshim, Perëndia mbetet po i njëjti. Qëllimi mbetet i njëjti si edhe rruga që ne ecim për atje, mbetet e njëjta.

Ne ndjekim pas Krishtin dhe këtë do ta bëjmë edhe në të ardhmen. Jezu Krishti është Zoti ynë, ai është rruga dhe ai do të vazhdojë së ndihmuari, po ashtu siç na ka ndihmuar deri për këtu.

Pokush është qëllimi ynë? Në fjalën tonë biblike përshkruhet: „Ibëkuar është ai që jubën ballë kundërshtimeve, tundimeve; sepse pasi të jetë sprovuar do të marrë kurorën e jetës, të cilën Perëndia ua ka premtuar atyre, që e duan Perëndinë.“ Kurora e jetës është një figurë e shpëtimit. Figura e kurorës përdoret shpesh në Bibël, ndonjëherë si këtu në lidhje me jetën: Kurora e jetës, ndonjëherë si „Kurora e drejtësisë“ (2Timoteut 4,8), „Kurora e madhështisë“ (1 Pjetri 5,4), dhe të gjitha këto figura përshkruajnë të njëjtën gjë: shpëtimin tonë, një figurë për jetën e përjetshme, për bashkimin me Perëndinë në Mbretërinë e tij. Për të përshkruar rrugën që duhet të ndjekësh, në mënyrë që ta marrësh këtë kurorë, shpesh Testamenti i Ri përdor krahasimin me një garë. Si apostul Pali ashtu edhe Jakobi i referohen kësaj figure. Edhe atëherë kanë ekzistuar gara të mëdha, ku atletët garonin për bast dhe fituesi pastaj merrte një kurorë – jo prej ari, por në formën e një kurore dafinash. Me këtë krahasim apostujt donin të bënin të qartë, se për të fituar jetën e përjetshme dhe për të hyrë në mbretërinë e Perëndisë, njeriu duhet të ecë po si një atlet.

Një garë kërkon së pari shumë energji. Për të fituar shpëtimin, ne duhet ta përputhim të menduarit dhe të vepruarit tonë me vullnetin e Perëndisë. Për t'u shpëtuar, njeriu duhet të ndjekë pas shembullin e Jezusit. Kjo kërkon energji dhe qëndrueshmëri si në një garë. Ajo nuk realizohet pa përpjekje. Kjo ishte pika e parë.

Për të hyrë në mbretërinë e Perëndisë njeriu duhet të vërë në përdorim shumë forca. Aty nuk është se futesh thjesht kështu, kjo është një garë, ajo kërkon qëndrueshmëri si në një garë.

Si atlet njeriu duhet të ushtrohet shumë. Çlirimi dhe shpëtimi nuk janë aktivitete të kohës së lirë, kjo është një sfidë e përditshme. Ne duhet të punojmë çdo ditë me veten. Ne duhet të sakrifikojmë shumë. Ne duhet të punojmë për ta sjellë në harmoni të menduarit dhe të vepruarit tonë me vullnetin e Perëndisë.

Për të hyrë në mbretërinë e Perëndisë, nuk mjafton vetëm që të marrësh pjesë në çdo shërbesë fetare, që të hedhësh

diçka në rutinë e sakrificës, që t'i lutesh Perëndisë e të jetosh si një i krishterë. Kjo kërkon shumë më tepër përpjekje, me qëllim që të bëhet me të vërtetë e sigurt se mendimet dhe të vepruarit tonë përkojnë me vullnetin e Perëndisë. Krahasimi me atletin e bën këtë gjë më të qartë.

Kush merr pjesë në një garë, ka shumë gjëra për të bërë, nëse kërkon të arrijë fitoren. Ndonjëherë i duhet të heqë dorë prej diçkaje, dhe ai e bën këtë pasi për të, fitorja është shumë e rëndësishme. Ndonjëherë na duhet që edhe ne të heqim dorë prej diçkaje, sepse shpëtimi është gjëja më e rëndësishme për ne. Dëshiroj ta bëja njëherë më konkrete: Ndonjëherë neve na duhet që të marrim një vendim. Mund të dëgjosh për shembull: „Nëse shkon atje, atëherë ti do të mund të fitosh shumë para.“ Sigurisht që leku na duhen të gjithëve. Por më pas vëmë re se atje nuk ka një bashkësi dhe se nuk qëndron mundësia për të shkuar nëpër shërbesa fetare. Atëherë lind pyetja se çfarë të bëj? A ta marr si të vërtetë ofertën, të shkoj atje? Atje do të mund të fitoja shumë lekë! Por ndoshta do të mund të shkojë veç tre ose katër herë në vit në shërbesë fetare. Si do të vendosësh? Disa thonë atëherë: „Sidoqoftë do të mund të kem një jetë më të mirë, pasi marr më shumë para.“ Por a je me të vërtetë i sigurt se do të kesh një jetë më të mirë pa marrjen e Darkës së shenjtë, pa ngushëllimin prej fjalës së Perëndisë, pa shoqërinë e motrave dhe vëllezërve? Këtu unë vendos një pikëpyetje.

Po ashtu si në një garë, njeriu duhet ndonjëherë edhe të sakrifikojë, nëse dëshiron që të hyjë në mbretërinë e Perëndisë. Atleti ndonjëherë duhet të jetë i gatshëm edhe për të sakrifikuar. Kjo gjë nuk kalon pa na prekur edhe ne. Në një ndeshje ekzistojnë rregulla, që duhet të kihet parasysh. çdo disiplinë ka të vendosura rregulla, të cilat duhet t'i ndjekësh nëse kërkon që të fitosh. Kjo vlen gjithashtu edhe për shpëtimin tonë. Jezusi e ka thënë këtë gjë shumë qartë. Ai ka folur për atë, se njeriu me të vërtetë mund të bëjë vepra të mira, por se ato nuk vlejnjë asgjë, nëse nuk zbaton disa rregulla të caktuara. Ai foli për ata që kishin realizuar gjëra të mëdha në emër të tij, të cilëve do t'ju thoshte: „Unë kurrë nuk ju kam njohur; largohuni prej meje, ju që shkelni ligjin.“ (Mateu 7,23).

Një rregull në këtë garë, e cila bëhet për shpëtimin shpirtëror, është edhe urdhëresa e dashurisë. Gjithçka që t'i bën bëje nga dashuria për Zotin dhe tjetrin. Gjithshka që

## *Kërkohet forcë e madhe për të koordinuar, për të përputhur mendimin dhe veprimin tonë me vullnetin e Perëndisë.*



bëhet pa dashuri është krejtësisht pa vlerë, ky është rregulli. Atë nuk e ka krijuar kisha apostolike e re. Këtë rregull e ka vendosur vetë Jezu Krishti. Edhe po të kishim bërë veprat më madhështore për Zotin, do të kishin qenë pa asnjë vlerë, nëse motivacioni ynë nuk do të kish qenë dashuria.

Një garë e tillë është diçka krejt tjetër, sesa një aktivitet sportiv në kohën e lirë, ku njeriu bën atë që don.

Nëse merr pjesë në një garë, duhet t'i përmbahesh rregullave të saj. Në garë nuk je kurrë vetëm, ka edhe të tjerë, të cilët nuk duan që të fitosh ti. Ky është principi i garës.

Por në garën për shpëtim shpirtëror, është diçka tjetër. Me qëllim që të përputhim jetën tonë, mendimet tona me vullnetin e Perëndisë, ne nuk duhet të luftojmë kundra të

tjerëve. Kundërshtar në këtë garë kemi djallin. Kundra atij luftojmë. Dhe unë mund t'ju siguroj, që ai do të përpiqet t'ju pengojë, që ju të fitoni garën. Ai do të bëjë gjithçka që më në fund të fitojë ai. Ky është armiku ynë.

## *Gjithshka që bën, bëje nga dashuria për Zotin dhe për tjetrin.*

Të gjithë ata, që përpiqen deri në maksimum, ata që respektojnë rregullat, që e duan Krishtin, që mbeten besnikë deri në fund, do të fitojnë kurorën. Por neve na duhet të luftojmë kundra

armikut tonë, kundra së keqes. Ne mund ta mundim atë me ndihmën e Zotit.

Në çdo ndeshje apo garë ka edhe një arbitër, një gjykatës. Ai kujdeset që të mbahen e respektohen rregullat dhe ai është i vetmi, i cili vendos, se kush është fituesi më në fund. Edhe në garën për shpëtimin ka një gjykatës: Jezu Krishti. Ai do të vendosë, se kush bën pjesë ndër fituesit. Ai do të vendosë



e gjykojë mbi mendimet dhe veprën e secilit prej nesh. Kjo gjë nuk i pëlqen gjithkujt, por Jezusi e ka thënë vetë, që ti do të gjykohesh sipas veprave tuaja.

Në fund të garës nuk mund të dal unë para Jezusit e të them: „Mirë, por shiko një herë, se çfarë kanë bërë të tjerët – njëlloj si unë!“ Atëhere nuk mund të them: „Të tjerët nuk i respektuan rregullat, prandaj nuk i kam respektuar edhe unë.“ Kur të rikthehet përsëri, do të më gjykojë nga veprat e nga mendimet e mia, pavarësisht nga fakti se çfarë kanë

bërë të tjerët. Ne nuk mund të nisemi nga çfarë kanë bërë të tjerët për të justifikuar sjelljen tonë. Ne duhet ta pranojmë që Jezusi do të na gjykojë dhe do të na pyesë për motivacionin tonë. Ata që do të pranohen janë ata që e duan Jezusin. Ne do të matemi nga masa e dashurisë dhe nga masa e dëshirës sonë për shpëtim. Kjo është baza e gjykimit. Sigurisht që ne nuk do të jemi gjithnjë fitimtarë mbi të ligën. Por mos harroni kurrë ju motra e vellezër: Ne do të matemi nga intensiteti i dashurisë sonë, nga vullneti ynë për t'u shpëtuar dhe nga vendosmëria jonë për të vepruar sipas vullnetit të Perëndisë. Nga njëra anë është ngushëllim, sepse do të pranohemi edhe kur ne nuk kemi përmbushur gjithçka. Nga ana tjetër ne duhet ta marrim shumë seriozisht, pasi po t'i hedhim një sy vetes, duhet ta pranojmë, se përpjekja për të plotësuar vullnetin e Perëndisë duhet të kishte qenë ndonjëherë edhe më e madhe.

Pra, ne kemi shumë energji për të përdorur, ne duhet të luftojmë, ne duhet të respektojmë rregullat, atë urdhëresë të dashurisë, ne duhet të luftojmë kundra armikut tonë, kundra së keqes dhe duhet ta pranojmë, që do të gjykohemi nga Jezu Krishti.

Pastaj kishim edhe një pikë të fundit që jo vetë atleti vendos, se kur zhvillohet gara. Ai nuk mund të thotë: „Oh, jo, jo sot! Nuk ndjehem mirë, le të fillojnë lojrat olimpike më mirë nesër!“ Dikush vendos fillimin e garës olimpike dhe për atë duhet të jesh i përgatitur më parë.



Apostuli i distriktit Urs Hebeisen (Azia Juglindore) do të dalë në pension – mbas 36 viteve në postin e apostulit. Në fjalën e ndarjes, apostuli kryesor Jean-Luc Schneider e përmbledhi punën e tij në tri emërues të përbashkët: Me pasion, me dashuri dhe me besim ndaj Perëndisë

Shumë vende, shumë popuj, shumë kultura. Nuk është detyrë e lehtë, kjo që Edy Isnugroho ka marrë përsipër si apostuli i ri i distriktit për Azinë Juglindore. Se si mund të arrihet kjo, apostuli kryesor e përmendi gjatë ngarkimit të tij me këtë detyrë



Perëndia ka vendosur, që gara të fillojë sot, e pikërisht që tani dhe këtë ne duhet ta pranojmë. Ne nuk mund t'i themi Jezusit: „Unë jam shumë i ri për këtë gjë, le ta shtyjmë garën edhe dhjetë vjet, kështu do të ishte në rregull.“ Gara zhvillohet sot, këtu në jetën tënde. Le të përdorim të gjithë forcën që ta fitojmë atë! Ne mund ta fitojmë atë me ndihmën e Jezusit, ne mund të fitojmë shpëtimin dhe së bashku me të edhe kurorën.

Nga se përbëhet shpëtimi? Unë sapo thashë nga kurora e jetës, nga jeta e përjetshme, nga bashkimi i përhershëm me Perëndinë. Kurora është shenja e fitores, shenja e lavdisë. Kush ka pjesë në ringjalljen e parë, kush e merr trupin e të ringjallurit, trupin e shndërruar, e tjetërsuar dhe hyn në mbretërinë e Zotit, ai ka pjesë në lavdinë e Jezu Krishtit.

Por kurora është edhe shenjë e sundimit, e pushtetit. Dhe thuhet që ata, të cilët do të fitojnë garën, që do të dalin futimtarë, do të sundojnë me Jezu Krishtin. Ata do të jenë priftërinj të Perëndisë dhe Jezusit dhe do të sundojnë me të për një mijë vjet (Zbul. 20,6).

Ne duhet ama të kemi të qartë, se çfarë do të thotë ky sundim. Në mbretërinë e paqes së Jezu Krishtit nuk do të ketë pushtet politik. Ky sundim nuk është zotërim, pushtet në aspektin politik dhe kohor. Kur Jezusi sundon do të thotë, se Ungjilli do të shpallet pa asnjë pengesë. Ky do të thotë sundim i Krishtit në mbretërinë e paqes mijëvjeçare. Ai do të sundojë dhe askush nuk do të mundë ta ndalojë atë për të shpallur Ungjillin e tij dhe për të shpëtuar njerëzit. Jezusi i qëndron besnik vetvetes. Ai do të sundojë si shërbëtor. Një shërbim i njeriut për të shpëtuar të gjithë njerëzit.

Kur thuhet se ne do të sundojmë së bashku me të, do të thotë kjo, që ata, të cilët do të jenë në mbretërinë e tij, do t'i shërbejnë atij dhe njerëzve, me qëllim që t'ju mundësojnë shpëtimin të gjithëve. Ata do t'u shpallin të gjithë njerëzve Ungjillin. Sundimi i tyre do të jetë një shërbim.

Jezusi dha një herë një shëmbëlltyrë, atë të pfundeve, të groshëve të besuara (Luka 19,11–27). Zotëria erdhi tek shërbëtorët e vet dhe u dha të dhjetëve nga një pfun, një grosh. Ata duhet të punonin me to, t'i investonin. Njëri që



Apostuli kryesor u shoqërua nga apostuli i distriktit Jürg Zbinden (Zvicër), Mark Woll (Kanada), Peter Schulte (Pacifiku Perëndimor) dhe nga Urs Hebeisen

shumë i zellshëm, i suksesshëm dhe bëri nga një pfund dhjetë. Kur zotëria u kthye i tha: „Në rregull, o shërbëtori im i mirë, meqenëse u tregove besnik në gjërat e vogla, ti do të kesh pushtet, do të sundosh mbi dhjetë qytete.“

Një tjetër e kish investuar atë grosh dhe kish fituar pesë prej saj. Zotëria e tij u gëzua për këtë gjë dhe i tha atij: „Edhe ti do të sundosh mbi pesë qytete.“ Shërbëtori dembel, i cili nuk kish bërë asgjë me pfundin, groshën e tij, nuk mori, nuk fitoi asgjë. Pra ata morën një shpërblim të ndryshëm. Njëri mori pushtet mbi dhjetë qytete, tjetri mbi pesë qytete.

Kush e kupton pushtetin si sundim, zotërim i diçkaje, mund të thoshte: „Është shumë mirë të kesh pushtet mbi dhjetë qytete. Është më mirë se të kesh pushtet mbi pesë.“ Por nuk është kështu. Nuk bëhet fjalë për sundim. Të gjithë janë shërbëtorë e shërbëtore. Në mbretërinë e paqes do t'i shërbejnë të gjithë Perëndisë. Por ne do të shërbejmë në mënyra e forma të ndryshme, secili sipas mundësive dhe aftësive të veta. E megjithatë ne do të mbesim shërbëtorë. Shërbimi do të jetë i ndryshëm, ndërsa kurora, shpërblimi

pra do të jetë i njëjtë. Ata do të jenë përherë pranë Jezusit. Kjo është kurora e jetës. Dhe fundi i historisë është: Të gjithë ata, të cilët do të banojnë në Krijimin e ri, do t'i shërbejnë Perëndisë dhe do të sundojnë me të. Kjo lidhje do të qëndrojë. Ata do të kenë pjesë në lavdinë, në madhësinë e tij dhe do t'i shërbejnë atij në përjetësi.

Kjo është e ardhmja jonë të dashur motra e vëllezër. Le të jemi garistë të vërtetë. Le të luftojmë çdo ditë, që mendimi dhe veprimi ynë të jenë në një ekuilibër, të përputhen me vullnetin e Perëndisë. Kjo është shumë e vështirë. Kjo do të thotë të vuajmë. A e pranojmë neve këtë!

Le të respektojmë rregullat, duke vepruar nga dashuria që kemi ndaj Zotit dhe tjetrit. Ne nuk duhet të luftojmë kundra vëllait apo motrës tonë. Ne duhet të luftojmë ndaj të ligut, ndaj të keqes. Ndonjëherë fitojmë, ndonjëherë humbasim, për këtë jemi të ndërgjegjshëm. Ajo që ka rëndësi është masa e dashurisë dhe dëshira jonë.

Le ta pranojmë këtë garë që tani. Besniku do ta fitojë garën. Ata, të cilët e duan Jezusin me të vërtetë, do ta fitojnë kurorën.

## MENDIME KYÇE.

Me qëllim që të fitojmë kurorën e jetës, ne duhet të luftojmë

- për të përshtatur mendimin dhe veprimin tonë me vullnetin e Perëndisë;
- për të respektuar atë ligj të dashurisë ndaj Perëndisë dhe ndaj tjetrit.

Të luftosh do të thotë të heqësh dorë nga shumë gjëra dhe të jesh gati të vuash.

Ata, të cilët do të dalin fitimtarë nga kjo garë, do të sundojnë me Jezusin në mbretërinë e paqes.



Një foto e përbashkët



Foto: NAK Shqipëri

# Përshtypje nga dita botërore e të rinjve Düsseldorf 2019

Përgatitjet për udhëtimin drejt Düsseldorfit kishin muaj, që kishin filluar dhe secili prej nesh po i jepte dorën e fundit këtyre përgatitjeve. Gëzimi dhe kënaqësia shihej në sytë e të gjithëve të rinjve dhe shoqëruesve të tyre. Përgjegjësia e tyre ishte e madhe. Udhëtimi nisi shumë herët në mëngjes në orën 04.25. Shumica e kishin nisur udhëtimin e tyre drejt aeroportit Rinas që në ora 12.00. Shumica madje nuk kishte vënë sy në gjumë. U takuam të gjithë bashkë në aeroport. Kishim bërë gati pasaportat dhe secili prej nesh u paraqit në sportelin Check – in për të marrë biletën e vet. Megjithëse pjesa më e madhe nuk kishin fjetur, përsëri ata ishin të gjithë të freskët. Në sytë e tyre nuk shikoje fare pagjumësi. Hipëm në aeroplanin e shoqërisë ajrore Austrian Airlines. Kënaqësi e madhe tek secili prej nesh.

Fluturimi nuk do të ishte i drejtpërdrejtë, por me tranzit në kryeqytetin e Austrisë Vjenë. Koha në dispozicion nuk ishte shumë, megjithatë arritëm te hyrja jonë për të vazhduar udhëtimin tonë drejt Düsseldorfit. Mbërritëm aty rreth orës 9 të mëngjesit. Pasi kryem procedurat e zakonshme në aeroport, dolëm jashtë dhe aty na priste motër Natasha, e cila do të na qëndronte pranë nesh dhe me ne gjatë gjithë qëndrimit tonë. I hipëm atuobusit, që të çonte në Messe Nord Düsseldorf. Fillimisht u parqitëm në sallën 6 për të marrë bazën materiale të nevojshme. Pastaj shkuam në sallën 15. Duke treguar fletëhyrjet tona u futëm brenda dhe zumë vendet tona, që na kishin caktuar. Pasi i bëmë gati gjërat tona, dolëm që të merrnim diçka për të ngrënë. Kështu shkuam në sallën 3, sepse shumë prej



Të rinjtë shqiptarë takojnë të rinjtë nga Krefeldi

nesh nuk kishin ngrënë mëngjes. Në bazën tonë materiale bënë pjesë edhe broshura me të gjitha aktivitetet, që do të zhvilloheshin gjatë gjithë këtyre katër ditëve. Të nesërmen pas mbërritjes sonë u zhvillua ceremonia e hapjes së Ditës Ndërkombëtare të Rinjve.

Apostulli kryesor Jean – Luc Schneider, pasi foli për rëndësinë e këtyre ditëve për Kishën Apostolike të Re, shtypi simbolikisht butonin e kuq, që deklaronte nisjen zyrtare të këtij aktiviteti madhështor mbarëbotëror. Kështu nisi “KËTU JAM UNË”.

U zhvilluan koncerte, biseda, takime dhe panairë të ndryshme. Ajo, që na u duk interesante, ishte fakti, që salla 6 ishte dedikuar stendave nga e gjithë bota. Edhe Shqipëria kishte stendën e vet, e vogël krahasuar me ato të shteteve të tjera pjesëmarrëse, gjithsesi për të ishte kujdesur motër Elsa dhe motër Natasha. Interesi për stendën tonë shqiptare ishte goxha i madh. Njerëz të ndryshëm interesoheshin për historinë, traditën dhe kulturën tonë. Momentet më të bukura për stendën tonë ishin, kur ajo vizitohej nga

vëllezërit gjermanë, që kishin shërbyer me vite në Shqipëri. Tek ata ndihej gëzimi dhe kënaqësia e madhe, sepse duke parë stendën tonë, atyre u vinin në kujtesë momentet më të paharrueshme, që kishin përjetuar në vendin tonë me motrat dhe vëllezërit shqiptarë. Të gjithë u ndjenë shumë të lumtur. Unë ndjeva shumë kënaqësi, kur pashë koncertet dhe takimet e organizuara nga motrat dhe vëllezërit e bashkësive të Ruisë, Kazakistanit, Tajlandës, Timorit Lindor, Belgjikës, etj, ku ata shpalosën në mënyrë më të bukur dhe më të mrekullueshme vlerat dhe traditat e tyre kulturore dhe historike. Kur shikoje dhe vështroje ata, mendoje se sa e larmishme dhe e shumëngjyrëshme është kjo botë, ku ne jetojmë. Koret ishin gjigande dhe të jashtëzakonshme, ku ata i këndonin dhe i thurnin lavde vetëm Perëndisë dhe Jezu Krishtit. Zemra dhe shpirti të mbushej me zjarr dhe dashuri, kur i qësëndisje ato. Pavarësisht se ne nuk njiheshim, ne të gjithë ishim motra dhe vëllëzër në Krisht.

Moment fantastik dhe mbresëlënës që, kur ne u takuam me motrat dhe vëllezërit dhe të rinjtë e bashkësive të Krefeldit,



Të rinjtë shqiptarë mbas përfundimit të shërbesës fetare të apostullit kryesor

të cilët me donacionet e tyre bënë të mundur udhëtimin e grupit të të rinjve shqiptarë në këtë ditë mbarëbotërore. Me ne u bashkua edhe apostulli ynë i mrekullueshëm Otten, i cili sa e zbukuroi më shumë takimin tonë. Ne kishim përgatitur disa dhurata simbolike si shenjë mirënjohjeje për motrat dhe vëllëzërit gjermanë. Aty i premtuam njëri – tjetrit, që kontaktet tona në të ardhmen do të shtoheshin më shumë dhe do të shpresoheshin më tepër në të ardhmen. Këtë gjë e vendosëm së bashku me drejtuesin e tyre, me vëllanë tonë Helmut Pohl. Aty si kujtim bëmë disa fotografi të përbashkëta. Unë i premtova gjithashtu grupit të të rinjve gjermanë, se këto momente do t' i përmendja në një shkrim në revistën tonë "Community" në versionin shqip. Në sytë e të gjithë grupit shikoje dashuri, kënaqësi, lumturi dhe mbi gjithçka besim të fortë. Pjesë e programit të grupit të të rinjve shqiptarë që dhe vizita e qytetit të mrekullueshëm të Düsseldorfit. Vizituam pjesën e vjetër të qytetit ose Altstadt. Kudo shikoje gjelbërim dhe jeshillëk. Të kënaqej syri me gjelbërimin. Të shplohesh syri. Dhe unë mendoja me vete: Po ne....? Pse ne jooooo? Të vinte shumë keq, por mbi të gjitha ndjeheshe shumë ligisht. Por shpresa është gjithmonë. Edhe ne do të bëhemi si ky vend. Ajo që më ra në sy, që fakti, që ky qytet po rindërtohej dhe po rikonstruktohej kudo. Dhe jo shkatërrim... Por qershia mbi tortë e të gjithë



Grupi shqiptarë arrijnë në aeroportin e Düsseldorf-it

aktivitetet gjatë gjithë këtyre ditëve intensive që shërbesa fetare e Apostullit Kryesor Schneider në stadiumin gjigand "Märker – Spiel – Arena", një stadium modern i mbyllur dhe i përshtatur për çdo lloj aktiviteti sportiv, kulturor dhe politik. Fjala që mori Apostulli Kryesor, që edhe motoja e këtij aktiviteti gjigand internacional "Këtu jam unë". Secili e ndjeu, se Perëndia ishte aty midis nesh. Ajo fjalë u ngulit shumë në zemrën tonë. Kjo shërbesë që dhe kurora mbretërore, që përmbylli të gjitha aktivitetet e parashikuara. Të nesërmen të gjithë të rinjtë do të bëheshin gati për t' u kthyer në vendet e tyre. Edhe grupi ynë bëri të nesërmen të gjitha valixhet gati. Po largoheshim nga Messe Nord Düsseldorf me mbresat dhe përshtypjet më të bukura dhe më të mirat. Kur po largoheshim nga ambjentet tona, kthëm kokat prapa dhe menduam: Siç e gjetëm të pastër, ashtu e lamë të pastër. Secili prej nesh u kthye në Shqipëri me mendimin: Me besim të Zotit e me punë arrihet çdo gjë, tamam si ky aktivitet madhështor.

## DARKA E MADHE

SIPAS LUKËS 14,15–24

*Eshtë e shtunë, Sabati. Jezusi është i ftuar për darkë nga një farise i rangut të lartë. Njëri, që qëndron ulur në tavolinë bashkë me ta, i thotë Jezusit: „Lum ata që do të marrin pjesë në gostinë e mbretërisë së Perëndisë.“ Pastaj kësaj Jezusi i tregon rrethit të tryezës një shëmbëlltysë:*

Ishte një njeri, i cili dëshironte të bënte një darkë të madhe dhe për këtë ftoi shumë njerëz. Kur darka duhej të fillonte, ai dërgon një shërbëtor te të ftuarit dhe iu lë fjalë atyre: „Ejani, pasi çdo gjë është gati!“

Ata njëri pas tjetri nisin të justifikohen.

I pari thotë: „Unë kam blerë një tokë dhe më duhet të dal, që të kujdesem për të; të lutem, i thuaj të më falë.“

I dyti thotë: „Unë kam blerë pesë pendë qe (çifte buajsh), dhe tani po nisem t’i shoh ato; të lutem, i thuaj të më falë.“

I treti thotë: „Unë sapo u martova; prandaj nuk mundem të vij.“

Shërbëtori kthehet dhe ia raporton këto zotërisë së tij.

Aty, zotëria e shtëpisë zemërohet dhe i thotë shërbëtorit: „Dil shpejt jashtë, nëpër rrugë dhe rrugica të qytetit, dhe sill të varfër, të verbër, të gjymtuar dhe të çalë.“ Shërbëtori i sjell të gjithë brënda dhe thotë: „Zotëri, u realizua ajo çfarë urdhëruat, por ka ende vend.“

Zotëria e dërgon edhe një herë shërbëtorin e tij: „Shko nëpër xhade e gardhe dhe nxiti njerëzit që të vijnë, që shtëpia ime të mbushet plot. Asnjërit prej burrave, të cilët u ftuan të parët, nuk do ta shijojë darkën time.“





## PËR VIZITË TEK MARIANGEL NË SAN JOSÉ (KOSTA RIKA)

Emri im është Mariangel. Unë e adhuroj kohën e mëngjesit të dielave, pasi atëherë ne takohemi me të gjithë familjen dhe hamë në qetësi së bashku. Pjatat e mija të preferuara janë spageti me djathë, supa me mish dhe patatet e skuqura.



Fotos: privat

Meqënëse prindërit e mi nuk mund të kujdesen për mua, unë jetoj me gjyshërit e mi. Gjyshja ime quhet Lena dhe gjyshi im Oscar Adolfo; unë i quaj ata Mami dhe Papi.

Pas mëngjesit të së dielës, ne nisemi për shërbesë fetare në kishën në Tirrases. Që prej vitit të kaluar unë shkoj në shkollën e së dielës. Mësimin e mbajnë Mami dhe tezja ime Fania. Që të dyja janë mësuese: Mami jep mësim në një shkollë fillore në San José, ndërsa tezja ime Fania është mësuese parashkollore. Përveç meje, shkollën e së dielës në bashkësinë time e ndjekin edhe Mathew, Mateo, Ema dhe Dominicku. Mua më pëlqen shumë të këndoj. Xhaxhai im Fabio i bie organos, që kur ishte fëmijë dhe ai na mëson këngë të reja.

Kjo foto është një kujtim i vizitës së apostulit tonë të distriktit Leonard R. Kolb. Ai banon në USA, por është përgjegjës edhe për Amerikën Qendrore, pjesë e së cilës është Kosta Rika.



Kosta Rika shtrihet midis Oqeanit Paqësor dhe Detit të Karaibeve. Vendi ia di për nder emrin zbuluesit të tij Kristofor Kolombit. Kur detari mbërriti në bregdet, ai vuri re se vëndalinjët mbanin veshur stoli të arta. Për këtë arsye Kolombi e quajti vendin Costa Rica (= bregdet i pasur).

Ne jetojmë në provincën numër 1 të Kosta Rikës, në kryeqytetin e vendit tonë; ai quhet San José.

Në maj unë mbush 11 vjeç. Unë jam në klasën e katërt të shkollës fillore, të quajtur sipas një heroi kombëtar të Kosta Rikës: Juan Santamaría. Ai ka shërbyer si një tamburist në ushtrinë e Kosta Rikës dhe me ndihmën e tij ushtria fitoi një betejë dhe ruajti pavarësinë e vendit. Lënda ime e preferuar është matematika; mua më pëlqen shumë të zgjidh probleme dhe ekuacione matematikore. Plus kësaj unë kam dëshirë të marr pjesë në një festival arti që bëhet për nxënësit. Në këtë vit unë do të aplikoj për lëndët: punim maske, vizatim me ngjyra dhe fotografi.

Mua më pëlqen të eci me skateboard dhe do të doja shumë që të mësoj t'i bie edhe violinës. Unë kam marrë mësimet organoje dhe në shkollë kam mësuar që t'i bie edhe pak fyellit. Në shtëpi mua më pëlqen shumë që të luaj me Lego dhe me kukullat e mia. Ngjyra ime e preferuar është ngjyra e purpurt, pink. Mendoj se është një ngjyrë shumë e gëzueshme.





# Të kuptuarit e postit

Photo: NAC South Africa

Tri llojet e postit, pesë shkallët, apo funksionet drejtuese, në të ardhmen jo më emërim të Evangjelistave, Barinjve, Evangjelistave të distrikteve, kryepleqve të distriktave, caktimi i Bischopeve, ndryshimi midis emërimit, ngarkimit me një detyrë dhe caktimit të një detyre – si dhe Të kuptuarit e postit në kishën Apostolike të re, na ofron gjëra të njohura por edhe të reja – Një pasqyrë, përmbledhje.

Të kuptuarit e postit bazohet në dëshminë e Testamentit të Ri dhe dëshiron t'i japë të drejtë punës dhe natyrës së personit Jezu Krisht. Posti i apostulit, i cili u krijua nga vetë Jezusi, ka detyrën të jetë, „administrator mbi misteret hyjnore“ (KNK 7.4.1 / KNK-FA 421–433). Kështu ai është gjithashtu i detyruar të hartojë dhe të përcaktojë rendin e posteve sipas nevojave bashkëkohore.

## Origjina e postit

„Çdo gjë që është themeluar dhe ajo çfarë kisha është sot, e ka origjinën e saj në personin dhe veprën e Jezu Krishtit, i cili është shpëtim dhe sjell shpëtim“ (KNK 6.2.2 / KNK-FA 368, 369). Jezu Krishti, kështu besojnë dhe pohojnë të gjithë të krishterët e konfesioneve të ndryshme, ka dy natyra: Ai është njeri i vërtetë dhe Perëndi i vërtetë (KNK

3.4.3 /KNK-FA 104–106). Personi Jezu, i cili është i skalitur nga të dyja këto natyra si dhe vepra e tij, formojnë masën, etalonin e kishës dhe gjithshka, që i përkasin detyrave dhe formës së saj. Prandaj, është e logjikshme që doktrina e kishës, shenjtërimet dhe postet të lidhen me doktrinën e dy natyrave. Prandaj duhet bërë i qartë përcaktimi i marrëdhënies ndërmjet personit dhe postit.

## Natyra e Postit

Posti dhe personi qëndrojnë në një lidhje të ngushtë. Ata janë të ndërthurur në mënyrë të çuditshme. Ka një korrespondencë midis dy natyrave të Krishtit dhe marrëdhënies ndërmjet postit dhe personit. Posti i referohet natyrës hyjnore, personi që mban këtë post i referohet natyrës njerëzore.



## Posti dhe personi

Aftësitë dhe cilësitë e mira që një person ka, do të vendosen në momentin e emërimit në shërbim të drejtimit të postit. Por me emërimin nuk është i lidhur asnjë transmetim i dhuntive të reja.

Vëllai i administratës është i lidhur me apostulatin dhe punon sipas vullnetit të Jezu Krishtit. Ai është shërbëtor i Perëndisë dhe i bashkësisë dhe përpiket të përhapë Ungjillin me fjalë dhe me vepra. Posti dhe personi, drejtimi i postit dhe i jetës duhet të jetë në përputhje me të dyja, në fjalë dhe në vepra, pas Jezu Krishtit.

Vëllai i administratës duhet të shpallë dhe përfaqësojë Ungjillin në kuptimin e Kishës Apostolike të Re dhe interpretimin e saj, ashtu siç ekziston në Katekizmin e Kishës Apostolike të Re. Vëllai i administratës gjithashtu shpreh sinqeritetin e tij ndaj Ungjillit, duke pranuar ofertat teologjike të kishës për mësim dhe ato që u mundësojnë atyre të udhëheqin në shërbim.

Eshtë e vërtetë që sipas Të kuptuarit të postit, ai dhe personi janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, por megjithatë jo në atë mënyrë që posti dhe personi të mos mund të ndahen përsëri. Posti nuk bëhet pronë e personit, nuk është pra një shenjë e pashlyeshme e personit, porse është dhe mbetet dhunti e Krishtit, që Jezu Krishti e ka, që ai e jep ose e mohon. Kështu jepet mundësia e zëvendësimit të postit.

## Posti dhe autorizimi

Jezusi është i Dërguari, i cili është pajisur prej Perëndisë me pushtetin përkatës. „sundimin dhe qeverisjen, pajtimin me Perëndinë, shpalljen e vullnetit të Perëndisë dhe parashikimin e së ardhmes: Të gjitha këto i gjejmë në një mënyrë të përsosur tek Jezu Krishti“ (KNK 3.4.7 / KNK-FA 116). Apostulati merr pjesë në autoritetin e Jezu Krishtit: „Posti i apostujve është i dhënë nga Krishti dhe i qeverisur nga Fryma e Shenjtë me autoritetin e vet: predikimin e Ungjillit, administrimin e shenjtërimeve, faljen e mëkateve“ (Mt 28,19; Joh 20,23; KNK 6.4.1.4). Apostuli, si i dërguari i Krishtit, ka si rrjedhojë pjesë në priftërinë e Lartë, për të cilën flet edhe letra drejtuar Hebrenjve (Hebr 4,14 / KNK-FA 425). Jo të gjitha postet kanë të njëjtin pushtet. Tri nivelet e posteve janë ngritur mbi fuqinë e ndryshme të posteve të veçantë: Apostul, Prift, Diakon. Në artikullin e pestë të besimit shkruhet: „Unë besoj, se ata të zgjedhur nga Perëndia mund të marrin autorizimin, bekimin dhe shenjtërimin në atë post vetëm nga apostuli në shërbim të tyre“ (KNK 2.4.5 / KNK-FA 37,45). Vëllezërit e administratës me detyrë priftërore dhe diakonët marrin pjesë në mënyra të ndryshme në pushtetin e postit të apostujve: Vëllezërve të administratës me detyrë priftërore

u janë besuar dhurimi i shenjtërimeve, si pagëzimi me Ujë, Darka e shenjtë, falja e mëkateve, shpallja e drejtë e Ungjillit, si dhe kryerja e veprimeve bekuese (KNK 7.9.1 / KNK-FA 452,469). Diakonët nuk kanë pushtet, fuqi shenjtëruese, e megjithatë po ashtu si vëllezërit e administratës me detyrë priftërore, ata kanë marrë forcën, fuqinë për të shpallur me drejtësi Ungjillin (KNK 2.4.5 /KNK-FA 45) dhe dhurimin e bekimit të trinisë në shërbesën, në shpalljen e fjalës pa liturgji.

## Autorizimi dhe dhurimi i shenjtërimeve

„Administrimi i gjerë i shenjtërimeve, që do të thotë pagëzimi me Ujë të shenjtë, Darka e shenjtë si dhe Vula e shenjtë, i është besuar postit të apostujve“ (KNK 6.4.4 / KNK-FA 402,404).

postit priftëror merr pjesë në autorizimin, në pushtetin apostolik të ri të dhurimit të shenjtërimeve; ai mund të ndajë Bukën e shenjtë dhe mund të kryejë pagëzimin me Ujë të shenjtë.

## Autorizimi i shpalljes së fjalës

„Detyra për të mësuar të tjerët përfshin shpalljen e Ungjillit rreth vdekjes së Jezusit, Ringjalljes dhe Rikthimit të tij“ (KNK 2.4.4 / KNK-FA 44). Këtu bëhet e qartë në radhë të parë përmbajtja e kontekstit, në të cilin ndodh shpallja e drejtë e Ungjillit.

Fjala e drejtë bazohet vetëm në fjalën e Krishtit, e cila dëshmohet në Testamentin e Ri. Nëse ajo bëhet e dëgjueshme, ajo do të zgjojë dhe forcojë besimin (Rom 10,17). „Fjala e Krishtit“, pra, predikimi i tij, i cili erdhi tek apostujt dhe bashkëkohësit e Jezusit, është transmetuar më tutje nga apostulati si dhe nga ato poste të tjera të autorizuara prej tij.

Tek „Mendime rreth pushtetit të postit“ (MU SN 03/2017, S.4 f.) apostuli kryesor thekson, se Bibla është baza e një predikimi të drejtë dhe se apostujt e sotëm kanë për detyrë dhe kanë edhe forcën të interpretojnë Biblën me ndihmën e Shpirtit të shenjtë. Edhe në lidhje me shpalljen e drejtë, priftat dhe diakonët kanë pjesë në autoritetin e apostulatis.

## Struktura e postit

Mbasi u fol për aspekte të shumta teologjike të Të kuptuarit të postit, duhet ta imagjinojmë si më poshtë vijon strukturën e postit.

Struktura e postit bazohet në tri shkallë, në tri lloj postesh: Posti i apostujve, i priftave dhe ai i diakonit, ku secili ka një pushtet shpirtëror të ndryshëm. Në të ardhmen do të

emërohen vetëm Apostujt, priftat dhe diakonët. Postet e tjera, si p.sh. kryeplaku i bashkësisë apo nëndiakoni, nuk do të emërohen më.

## Pushteti i postit dhe detyra e postit

Të tre posteve u janë dhënë kompetenca, pushtete të qarta. Përkufizimi i pushtetit, i autorizimit bazohet vetëm në atë që veprimet (dhurimi i shenjtërimeve, kryerja e veprimeve bekuese, shpallja publikisht e Ungjillit) u janë dhënë apo u janë autorizuar për t'u kryer çdo posti përkatës.

Një post përfshin si pushtetin e postit, ashtu edhe detyrën që ai post mban. Fuqia, pushteti i një posti është e një natyre teologjike, ndërsa detyra që ai post mban, është e një natyre kishtarë.

- Definicioni, përkufizimi pushtet i postit: Pushteti i postit është ajo e drejtë e bazuar në Jezu Krishtin, por e transmetuar nga apostujt me forcën e Shpirtit të shenjtë së bashku me emërimin për të vepruar dhe folur, në emër të trinisë së Perëndisë.:  
Pushteti i postit jepet së bashku me emërimin. Ai pushtet shuhet me marrjen apo heqjen dorë të postit nëpërmjet Apostulit, nëpërmjet heqjes nga posti apo me vdekjen.
- Përkufizimi i ngarkimit me detyrë: Me ngarkimin e një detyre, vëllezërve të administrates ju ngarkohet gjithashtu e drejta dhe detyrimi për të kryer shërbimin e tij, të cilin e ka marrë së bashku me pushtetin e postit, gjatë një periudhe kohore dhe brenda një kornize të caktuar.  
Ngarkimi i një detyre përfundon me ndryshimin e kushteve, me daljen në pension, me largimin nga detyra nëpërmjet një apostuli, si dhe me heqjen dorë prej saj apo me vdekjen.

## Emërimi – Ngarkimi i një detyre – Caktimi në një detyrë

Emërimi, Ngarkimi i një detyre dhe caktimi në detyrë. Këto tri kategori ndryshojnë në përmbajtje nga njëra-tjetra: Me një emërim transmetohet një fuqi, një pushtet i një posti. Me ngarkimin e një detyre transmetohet një funksion shpirtëror veprues e administrues. Me caktim në një detyrë i besohet dikujt një shërbim me fokus shpirtëror. Gjatë një emërimi, ngarkimi i një detyre apo caktimi në një detyrë vlerësohen njëlloj kompetencat personale dhe profesionale. Ngarkimi i një detyre apo caktimi në një detyrë mund të kufizohen në kohë.

Emërimet dhe ngarkimet me detyrë bëhen gjatë një shërbese fetare mbas marrjes së Darkës së shenjtë. Ato kryhen duke u ulur në gjunjë, duke u gjunjëzuar.

## Emërimi i apostujve, priftave dhe diakonëve

Fakti që Perëndia zgjedh dikë për një post dhe që kjo është baza e çdo emërimi, është gjithashtu e vlefshme plotësisht edhe në rregulloren e posteve zyrtare. Emërimi në një detyrë është veprimi i Perëndisë në mëkatarin për shërbimin ndaj Perëndisë dhe njeriut: „Emërim është vendosja në një post shpirtëror. Emërimi kryhet në emër të Trinisë së Perëndisë nga një apostul, duke shtrirë duart mbi kokë dhe duke u lutur. Së bashku me të merret edhe autorizimi, pushteti pra, shenjtërimi dhe bekimi. Ai kryhet duke marrë parasysh ato kompetenca, të cilat janë të domosdoshme për postin përkatës. Përpara se të shtrihen duart mbi kokën e atij që do të emërohet, kërkohet ndihma e Shpirtit të shenjtë për plotësimin e këtij shërbimi“ (MU SN 04/2017). Emërimi nënkupton atë akt, gjatë së cilit transmetohet jo vetëm pushtet e fuqi, por edhe bekim e shenjtërim. Në postet e mëposhtme do të emërohen:

- Apostuli kryesor dhe apostujt
- Priftat
- Diakonët

## Pushteti, fuqia e postit të apostulit, Priftit dhe Diakonit

Me një rëndësi shumë të madhe është Apostulati, ku gjenden të gjitha forcat, fuqitë shenjtëruese, ato, të cilat janë të domosdoshme për Kishën në përgjithësi – pra, dhurimi i pagëzimit me Ujë, Darka e shenjtë, Vula e shenjtë si dhe shpallja e Ungjillit. Pushteti i posteve të tjera rrjedh nga pushteti i Apostulit. Prandaj edhe artikulli i pestë i besimit tingëllon kështu: „Unë besoj, se ata që Zoti ka zgjedhur për një post mund të vendosen në të vetëm nëpërmjet apostulit dhe se prej postit të apostulit rrjedh pushteti, fuqia, bekimi dhe shenjtërimi në shërbim të tyre.“

Prifti merr gjatë emërimit përveç pushtetit, fuqisë për të shpallur drejt Ungjillin, edhe forcën për të falë mëkatet, të autorizuar apo me porosi të apostulit të tij; ai fiton pushtetin për të dhuruar shenjtërimet e pagëzimit me Ujë dhe Darkën e shenjtë si dhe pushtetin e kryerjes së veprimeve bekuese. Pushteti për të shpallë faljen e mëkateve si dhe dhurimi i dy shenjtërimeve të përmenduar më sipër është – krahas bekimit dhe shenjtërimit – një pajisje shpirtërore, e cila transmetohet nga një Apostul me forcën e Shpirtit të shenjtë.

Diakoni merr gjatë emërimit pushtetin, forcën, pra atë pajisje shpirtërore, e cila transmetohet nga një Apostul me forcën e Shpirtit të shenjtë, për të shpallur drejt Ungjillin në një shërbesë fetare apo në një vizitë nëpër familje si dhe dhurimin e bekimeve treshe në një shërbesë pa liturgji.

## Ngarkimi me një detyrë i apostujve dhe i vëllezërve të administratës me detyrë priftërore

Vëllezërve të administratës mund t'ju ngarkohen detyra si një funksion drejtues brenda një zone kishtare, brenda një distrikti ose një bashkësie.

Edhe pse posti i apostujve ka një karakter udhëheqës „qeverisës“, d.m.th. pjesëmarrës në tri postet e Krishtit: Mbret, Prift edhe Profet (KNK 3.4.7 / KNK-FA 116), apostujve mund t'u besohen funksione të mëtejshme udhëheqëse. Vëllezërve të administratës me detyra priftërore mund t'ju ngarkohen detyra të tjera me funksion drejtues brenda një distrikti ose një bashkësie.

- Një apostul mund të ngarkohet me detyrën e apostulit të distriktit.
- Një vëlla admin. me detyrë priftërore ngarkohet me detyrën e drejtuesit të një distrikti ose të një bashkësie.

Ngarkimi në detyrë bëhet në emër të Trinisë së Perëndisë nga apostuli kryesor, ai i distriktit apo nga apostuli si dhe në raste të veçanta edhe nga një vëlla admin. i ngarkuar nga një apostul, duke shtrirë duart mbi kokë dhe duke u lutur. Së bashku me emërimin merret edhe shenjtërimi e bekimi. Ai kryhet duke marrë në konsideratë kompetencat personale (p.sh. kompetenca për kujdestari shpirtërore, mësimdhënie dhe organizim), të cilat janë të domosdoshme në funksionet drejtuese si dhe janë të lidhura me shërbimin përkatës. Ngarkimi me një detyrë nuk është i lidhur me kohëzgjatjen e një posti; megjithatë përfundon me përfundimin e tij.

## Caktimi nëpërmjet apostujve dhe vëll. të admin. me detyrë priftërore

Caktimi është transmetimi, dhënia e një shërbimi shpirtëror. Ai jepet dhe përfundon po prej një apostuli apo vëllai admin. me detyrë priftërore, i ngarkuar prej tij. Ai kryhet duke marrë në konsideratë kompetencat personale (p.sh. kompetenca për kujdestari shpirtërore, mësimdhënie dhe organizim), të cilat janë të domosdoshme në funksionet

drejtuese si dhe janë të lidhura me shërbimin përkatës. Për plotësimin e këtij shërbimi kërkohet me anë të lutjes bekimi i Perëndisë.

Apostuli kryesor, apostujt e distrikteve, apostujt dhe vëll. e admin. me detyra priftërore, të cilët kanë funksione drejtuese, duhet të kenë një mbështetje të veçantë nëpërmjet ndihmësave apo përfaqësuesve të tyre:

- Një apostul mund të caktohet ndihmës-apostul kryesor, ndihmës-apostul distrikti ose „Apostul-drejtues“.
- Një vëlla admin. me detyrë priftërore mund të caktohet bishop ose ndihmës-apostul.
- Një vëlla admin. me detyrë priftërore mund të caktohet përfaqësues i drejtuesit të distriktit apo të bashkësisë.

## Përfundimi, mbarimi i detyrës dhe i pushtetit të postit

Posti së bashku me dy komponentët, pushteti i postit dhe detyra e tij, mund të përfundojnë, të mbarojnë në mënyra të ndryshme. Me daljen në pension mbaron, përfundon vetëm detyra, ndërsa me heqjen dorë, largimin nga posti apo me marrjen e tij, përfundon si pushteti i atij posti, ashtu edhe detyra e deriatëhershme e lidhur me të.



Photo: Klaus Emmertling

Masthead

Autori: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zyrih/Zvicër  
Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Germany  
Editori: Peter Johanning



# Pasqyra

- 06.07.2019 Inkisi (RD e Kongos)
- 07.07.2019 Kinshasa (RD e Kongos)
- 20.07.2019 Ndola (Zambia)
- 21.07.2019 Lusaka (Zambia)
- 28.07.2019 Norderstedt (Gjermani)
- 02.08.2019 La Paz (Bolivi)
- 04.08.2019 São Paulo (Brasil)
- 11.08.2019 Zürich (Zvicër)
- 18.08.2019 Brampton (Kanada)
- 15.09.2019 Apia (Samoa)
- 15.09.2019 Pago Pago (Samoa Amerikane)
- 22.09.2019 Christchurch (Zelanda e Re)

New Apostolic Church  
International

